

**AKT- THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“AMICO” SH.P.K.**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve themelues te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **“AMICO” Sh.p.k.**

**1- ERJONA CIKO** atesia **NIKOLLAQ**, shtetase SHQIPTARE, lindur me 09.08.1974 ne TIRANE, identifikohet nepermjet ID H45809104N.

Në përputhje me vullnetin e tyre te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendoset të hartojnë këtë akt themelimi të shoqërisë **“AMICO” Sh.p.k.** mbi bazen e ketyre principeve:

**NENI 1  
FORMA DHE EMRI**

Shoqëria ka formen e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me initiale SH.P.K., dhe i perballon humbjet deri ne kufirin maksimal te vleres se kontributit te ortakeve ne kapitalin themeltar. Emri i shoqerise **“AMICO” Sh.p.k.**,

**NENI 2  
BAZA LIGJORE**

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, Ligji me Nr.9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me marreveshjet nderkombetare te ratifikuara dhe qe do te ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.

**NENI 3  
SELIA**

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Njesia Bashkiake Nr.8, Rruga e Dibres, Kompleksi Halili, Dyqani Nr.3, Tirane, Shqiperi.

Në adresën e mesiperme do të identifikohet qendra e personit juridik.

Me vendim te asamblese, mund të hapen dege, filiale, agjensi ose perfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqiperise sipas fushave ne te cilat e ushtron veprimtarine shoqëria.

#### **NENI 4**

#### **KOHEZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQERISE**

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pa përcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit ne organin kompetent. Shoqëria priset dhe kalon në procedure likujdimi, sipas rasteve te parashikuara me ligj.

#### **NENI 5**

#### **OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Zhvillimin e aktivitetit Bar-Kafe.

#### **NENI 6**

#### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar i shoqërise është 100.000 LEKE, i ndarë në 1 pjesë .Kapitali themeltar i shoqërise zoterohet nga:

<b>1. ERJONA CIKO</b>	<b>100,00%</b>	<b>100.000,00 LEKE</b>
-----------------------	----------------	------------------------

Kapitali themeltar i shoqërise është shlyer tërësisht dhe depozituar ne nje llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dyte.

#### **NENI 7**

#### **AKTET E SHOQERISE**

Shoqeria do te rregullohet, pervec këtij akt-themelimi edhe me norma te percaktuara ne statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërise dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërise.

#### **NENI 8**

#### **ORGANET DREJTUESE**

Organet drejtuese të shoqërise do të jenë Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve dhe Administratori. Shoqëria mund të emëroj më shume se një administrator. Në çdo

rast, kur termi “Administrator” përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërise “AMICO” Sh.p.k., ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numer. Përveç organeve të parashikuara më sipër asambleja e ortakëve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezgjatja dhe kompetencat e tyre. Administratorët e shoqërise për një periudhë 5 (pese) vjeçare janë emeruar:

**1- ERJONA CIKO**

### **NENI 9 DISPOZITAT E FUNDIT**

Çdo mosmarrveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zhgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarrveshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tiranë.

Ky akt themelim është hartuar në 3 (tre) ekzemplarë në gjuhën shqipe, duke patur secili ekzemplarë fuqi të njëjtë ligjore.

**Tirane 12/03/2021**

**ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE  
“ AMICO” SH.P.K.**

**ERJONA CIKO**



